



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-29902/25 datë:26.11.2025



Npi – 01/333 datë: 05.12.2025

Duke u bazuar në nenin 42 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës: 27.04.2023, për mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 05.12.2025 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES INAUGURUESE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 05.12.2025, (e premte) në ora 11.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i mbledhjes: z.Haqif Arifi (Anëtari më i vjetër) Antarët e Kuvendit: z.Adnan Ademi, z.Grejtalb Emini, z.Besnik Seferi, z.Halil Kurtishi, z.Zenel Shabani, znj.Yllkë Fejzullahu, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani, z.Rrahman Jakupi, z.Jakup Ismajli, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Sylja, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari i ri i zgjedhur z.Qemajl Aliu; Përfaqësues të Shoqatave të dalura nga lufta e UÇK-së; Përfaqësues të OJQ-ve dhe të Bashkësisë Islame z.Driton Zenuni; Komandanti i Zjarrëfikësve z.Bajram Gashi; Komandanti i Stacionit të Policisë në Shtime z.Haxhi Behluli; Kryetari i shoqatës së intelektualëve prof.Banush Imeri; Kryetari i fshatit Reçak z.Adem Ramadani; Drejtori i QKMF-së z.Illiaz Kadrijaj; Nga SHKSH, z.Gëzim Gashi; Nënkryetari, z.Faruk Beqa; Shefja e Kabinetit, znj.Anita Kurti; DAP, z.Imri Hoxha; DBF, z.Besnik Ahmeti; DSHP, z.Bardhyl Rushiti; DPP, z.Valon Januzi; DSHMS, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi; Zyrtarë Komunal; Zyrtarë të institucioneve lokale, si dhe nga mediat, nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha; TV- Kosova Press; Mysafir nga mërgata si dhe shumë qytetarë.

Mbledhjen e hapi anëtari më i vjetër për nga mosha z.Haqif Arifi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve të ri të Kuvendit prezent në mbledhje.

Për këtë mbledhje Kryetari i ri i zgjedhur i Komunës së Shtimes z.Qemajl Aliu ka propozuar këtë:

REND DITE

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të ri të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
2. Dhënia e betimit të Kryetarit të ri të Komunës, z.Qemajl Aliu,

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arifi; Të nderuar qytetarë të Komunës së Shtimes, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Shtimes, i nderuari Kryetar i Komunës z.Qemajl Aliu, të nderuar përfaqësues të institucioneve Komunale, përfaqësues të subjekteve politike, të organizatave të dala nga lufta, të nderuar familjar të dëshmorëve, invalidë e veteranë të luftës, qytetarë të pranishëm, të nderuar përfaqësues të mediave, të shoqërisë civile, zonja dhe zotërinjë, me ftesë të Kryetarit z.Qemajl Aliu jemi të ftuar në këtë mbledhje inauguruese të Kuvendit të Komunës së Shtimes e cila do të mbahet sot më 05.12.2025. Kam nderin dhe përgjegjësin që, si anëtari më i vjetër i këtij Kuvendi të hapë këtë seancë të parë konstituive të legjislaturës së re të Kuvendit Komunal të Shtimes. Më lejoni, që me nderimin më të lartë dhe përgjegjësin që kërkon kjo ditë, të ju urojë mirëseardhje në senacën

konstituive të Kuvendit Komunal të Shtimes: Kolegeve të zgjedhur delgat të ri, Kryetarit të ri të zgjedhur z.Qemajl Aliu dhe të gjithë të pranishmëve. Ky është një moment i rëndësishëm institucional, sepse me këtë senacë nis zyrtarisht puna e përfaqësuesve të rinjë të qytetarëve tanë. Para se të vazhdojmë me rendin e ditës më lejoni që në emër të gjithë të pranishmëve të shprehim nderimin më të lartë për të gjithë dëshmorët, martirët, invalidët, dhe veteranët e luftës për liri, të cilët me sakrificën e tyre bënë të mundur që ne sot të jemi të lirë e të punojmë në institucionet demokratike. Në mënyrë të veçantë le të kujtojmë me respekt të thellë ngjarjet e Reçakut, plagën e dhimbshme që preku zemrat e të gjithë Kombit tonë, e që u bë simbol i së vërtetës për Kosovën. Nderimi ynë shkonë edhe për familjen e dëshmorëve, për të mbijetuarit e luftës, për invalidët dhe të gjithë ata që i qëndruan historisë në krahun e drejtë. Lavdi e pëjetshme për të rënë për liri.

Në vazhdim konstatohet kuorumi prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Mbledhjen do ta vazhdojmë me zgjedhjen e komisionit verifikues prej 3 anëtarëve. Hapi diskutimin për të dhënë propozimet ju si grupe parlamentare.

z.Adnan Ademi: Përshëndetje. Në emër të grupit parlamentar të VV-së propozojë për anëtarë të Komisionit Verifikues Besnik Seferin.

z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Në emër të grupit parlamentar të PDK-së propozojë për anëtarë të Komisionit Verifikues Demokrat Mujota.

z.Shefqet Krasniqi: Përshëndetje. Në emër të grupit parlamentar të LDK-së propozojë për anëtarë të Komisionit Verifikues Frosina Berisha-Ahmeti.

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arifi: Para se ti hedhë në votim konstatohet kuorumi prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht aprovoi Vendimin për zgjedhjen e Komisionit Verifikues, me qëllim të njohjes dhe verifikimit të mandateve të anëtarëve të ri të Kuvendit, të zgjedhur në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura më 12.10.2025, në këtë përbërje:**

1. Frosina Berisha-Ahmeti - Kryetare e Komisionit,
2. Besnik Seferi - Anëtar,
3. Demokrat Mujota - Anëtar.

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arifi: I ftoi Anëtarët e Komisionit që të ulen bashkë dhe të fillojnë punën e tyre.

Komisioni Verifikues është ulur bashkërisht dhe e kanë zgjedhur Kryesuesen e Komisionit, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, e cila në vazhdim i ftoi me emër dhe mbiemër të gjithë anëtarët e ri të Kuvendit, dhe në fund Konstatohet se janë verifikuar të gjitha mandatet e anëtarëve të ri të Kuvendit. Të gjithë anëtarët janë prezent në mbledhje, dhe konstatohet se nuk ka asnjë pengesë për vazhdimin e mbledhjes Inauguruese me dhënjën e betimit.

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arifi: Faleminderit nga Komisioni, tani e hapi diskutimin për rendin e ditës. Pasi që diskutime nuk ka, po e hedhë rendin e ditës për votim ashtu siç ka ardhur nga Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu. Konstatohet kuorumi prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Dhënia e betimit të anëtarëve të ri të Kuvendit të Komunës së Shtimes

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arifi: Fillimisht dua që të ju njoftoj me tekstin e betimit dhe me mënyrën se si do të procedojmë. Unë do ta lexoj tekstin e betimit, ndërkaq që ju të ngritur në këmbë të gjithë bashkërisht me zë e thuani emrin tuaj dhe në fund edhe fjalën "Betohem". Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arifi, lexoi tekstin e betimit dhe në fund të gjithë anëtarët e Kuvendit njëzërit e thanë fjalën "Betohem". Duke i uruar punë të mbarë anëtarëve të Kuvendit.

***Konstatoi se nga ky moment është Konstituuar Kuvendi i ri i Komunës së Shtimes dhe mund të vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.**

Pika 2

Dhënia e betimit të Kryetarit të ri të Komunës, z.Qemajl Aliu

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arifi: E ftoi Kryetarin e Komunës së Shtimes z.Qemajl Aliun që të del te foltorja para Kuvendit për të dhënë betimin.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Doli te foltorja dhe pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoi tekstin e betimit (deklarata solemne) para anëtarëve të Kuvendit dhe para qytetarëve, i paraparë me nenin 57.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe në fund tha "Betohe".

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arif: I uroj punë të mbarë Kryetarit z.Qemajl Aliu.

***Konstatoj që është betuar Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu i cili nga tash e tutje i ushtron kompetencat e plota të Kryetarit të Komunës së Shtimes.**

Kryesuesi i mbledhjes, z.Haqif Arif: E ftoj Kryetarin z.Qemajl Aliu për një fjalë përshëndetëse.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: I nderuar Kryesues i kësaj seance inauguruese të Kuvendit të Komunës, z.Arifi, të nderuar asambleistë, të nderuar familjarë të dëshmorëve e martirëve, të nderuar invalidë e veteranë të luftës së UÇK-së, të nderuar veteranë të arsimit, intelektualë e veprimtarë të çështjes kombëtare, përfaqësues të subjekteve politike, i nderuar kryetar i shoqatës së Veteranëve të UÇK-së, z.Rashiti, i nderuar komandant i Stacionit të Policisë, z.Behluli, i nderuar Komandant i Zjarrëfikësve në Shtimes, z.Gashi, i nderuar përfaqësues të Bashkësisë Islame, z.Driton Zenuni, i nderuar kryetar i shoqatës së intelektualëve të Shtimes, prof.Banush, i nderuar kryetar i fshatit Reçak, z.Ramadani, i nderuar drejtor i QKMF-së z.Kadrijaj, drjetor i SHKSH, z.Gashi, të nderuar përfaqësues të komuniteteve, përfaqësues të shoqërisë civile, të nderuar përfaqësues të mediave, të dashur bashkëqytetarë të Shtimes, të nderuar të pranishëm, motra dhe vëllezër, së pari, më lejoni t'ju uroj funksionalizimin e Kuvendit Komunal dhe secilit prej asambleistëve të zjedhur t'ju shpreh urimet më të sinqerta për besimin që kanë marrë nga qytetarët për t'i përfaqësuar në këtë institucion të nderuar. Sot është një ditë e shënuar, sepse qytetarët e konfirmuan edhe një herë vullnetin e tyre që mirëqeverisja dhe vazhdimi i punëve të mira të jenë prioritet. Jam i lumtur të theksoj se premtimi i dhënë në vitin 2021, pikërisht në këtë sallë, sot është realitet, dhe Shtimja është bërë një vend me i zhvilluar, më i mirë për të punuar, një mjedis më cilësor për t'u arsimuar dhe një ambient më i shëndetshëm për të jetuar. Besimi që na u dha në vitin 2021 u kthye në punë e rezultate konkrete. Përveç se paguam shume borxhe, ndryshuam mentalitetin qeverisës, e kthyem qeverisjen te qytetari, e rritëm transparencën komunale në 100%, fituam poashtu edhe çmime vendore e ndërkombëtare për qeverisje lokale të shkëlqyer. Gjatë mandatit të parë realizuam mbi 50 milionë euro investime, duke përfshirë projekte të prekshme e të shpërndara gjithandej në qytet dhe në çdo fshat, që e kanë lehtësuar dhe përmirësuar jetën e banorëve tanë dhe që po e transformojnë rrënjësisht komunën tonë. Të gjitha punëve të mira dhe të mëdha të mandatit të parë, me besimin e palëkundur të qytetarëve, po u shtojmë edhe 60 zotime të reja, të cilat e plotësojnë vizionin tonë për një Shtime të barabartë, të drejtë dhe të zhvilluar. Andaj, të dashur qytetarë, ju shpreh mirënjohjen time të thellë për besimin që më keni dhënë sërish për t'ju përfaqësuar në krye të shtëpisë sonë të përbashkët, Komunës. Ky besim është nder dhe përgjegjësi, dhe na obligon të vazhdojmë punët e mira në shërbim të çdo qytetari. Të nderuar asambleistë, nga sot, ju jeni zëri i qytetarëve në këtë sallë, dhe detyra që mbani është njëkohësisht përgjegjësi e madhe dhe obligim për të dhënë më të mirën për vendin tonë. Dua t'ju siguroj se jam plotësisht i gatshëm për bashkëpunim me të gjithë, pa dallime politike apo personale. Po ashtu, pres nga ju të njëjtin angazhim, me korrektësi, respekt dhe ballafaqim të denjë të ideve dhe projekteve që i shërbejnë interesit të qytetarëve tanë. Për hir të së vërtetës, asambleja në mandatin e kaluar ka qenë më shumë penguese dhe bllokuese, sesa e fokusuar në interesin dhe prioritetet e qytetarëve. Uroj që një gjë e tillë të mos përsëritet më kurrë duke ju ftuar secilin prej jush që të punojmë bashkë për ditë më të mira të pasardhësve tanë, që do të ndihen

krenarë për gjyshërit që luftuan për pavarësi e liri e për neve që punuam t'ua mbajmë gjallë amanetin e tyre, për liri, drejtësi dhe të ardhme më të mirë. Te dashur qytetarë, besimi që më keni dhënë për të qenë në krye të komunës sonë këto dy mandate rresht, është nderi më i madh i jetës sime. Jemi komunë e vogël, por me njerëz me zemer të madhe, bujar, trima e fisnik. Kjo trevë ka ditur gjithmone të jap bijë e bija të zot, intelektual e që i dalin zot vendit kurdo e në çdo kohë. Jam krenar që komuna jone ka ditur të jetë në ballë të luftës sonë çlirimtare, me djemtë e vajzat e saj më të mira, që në orët e para të luftës sonë për liri, duke dhënë mbi 50 Dëshmorë, mbi 80 martirë, mbi 800 ushtarë të lirisë e përmes gjakut të martirëve të Reçakut, me u bërë pikë kthese e lirisë dhe shtetit tonë të pavarur që po e gëzojme bashkë. Zotohem këtu para jush, që ashtu siç jemi munduar të bejme punë të mira këto katër vite, ashtu do të veprojmë edhe më tutje, ta nderojmë të kaluarën tonë të lavdishme e krenare, të punojmë fort për ta zhvilluar e prosperuar vendin tonë e për t'i hapur perspektivë brezave që do vijnë. Busulla jonë e orientimit në çdo veprim që do bëjmë do të jetë pikërisht gjaku i derdhur i dëshmorëve e martirëve, plagët e invalidëve të luftës së veprimtarëve të kauzes tonë kombëtare brez pas brezi. Bashkë do t'ia dalim dhe do t'i përmbushim të gjitha zotimet tona, sepse pikërisht për këtë na kanë besuar qytetarët e Komunës së Shtimes. Na priftë e mbara, dhe qofshim bashkërisht faqebardhë në punët dhe përgjegjësitë që na presin, duke vepruar gjithmonë në pajtim me normat ligjore, morale dhe parimet demokratike. Zoti e bekoftë Shtimen, Zoti e bekoftë Kosovën e qytetarët e saj, Zoti e bekoftë Shqipërinë e kombin shqiptar! Faleminderit shumë.

Kryesuesi i mbledhjes, z. Haqif Arif: Të nderuar kolegë, qytetarë, përfaqësues të institucioneve dhe organizatave, me kryerjen e të gjitha pikave të rendit të ditës, më lejoni që ta mbyllë këtë senacë konstituive me një mesazh që besoj që na bashkon të gjithëve:

Kuvendi Komunal është institucion ku përfaqësohet vullneti i qytetarëve tonë. Detyra jonë, e imja dhe e secilit nga ju është të punojmë me përgjegjësi, me etikë me transaprency dhe me bindje se çdo vendim duhet të i shërbejë interesit të Komunës së Shtimes dhe qytetarëve tanë. Duke ju uruar punë të mbarë dhe mandate të suksesshme e shpallë të mbyllur senacën e parë konstituive të Kuvendit Komunal të Shtimes në ora 11:44h.

Procesmbajtëse:

Sadbere Halili

Halili



Kryesuesi i Mbledhjes

Haqif Arifi

Arifi